



www.analyticamk.org //////////////

analytica 
thinking laboratory...

“LUFTËTARËT E HUAJ” - A DUHET TË KEMI FRIKË NGA RESOCIALIZIMI DHE REINTEGRIMI I TYRE?

DHJETOR 2015

commentary

□RADIKALIZIMI dhe fenomeni i luftëtarëve të huaj kanë trondit botën për tmerrin që ata janë duke përhapur dhe duke qenë një kërcënim i përmasave globale kjo paraqet shqetësim edhe për rajonin e Ballkanit si dhe të Maqedonisë.

Nga Maqedonia aktualisht ka rreth 110 luftëtarë që luftojnë në frontet e ISIS-it ose Al Nusrës në Siri apo Irak. Nga këto, deri tani 25 janë vrarë dhe rreth 69 besohen të janë kthyer mbrapa në Maqedoni.¹ Institucionet e sigurisë në vend akoma duhen të zhvillojnë strategji të mirëfilltë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm fetar në Maqedoni. Edhe pse shteti ynë merr pjesë në koalicionin botëror për luftimin e Daesh-it², përbrenda ballafaqohet me mungesë të një strategjie për parandalimin e radikalizimit të qytetarëve të saj. Nuk ka asnjë program tjetër në dispozicion për reintegrimin e luftëtarëve të huaj tashmë të kthyer, sërish në shoqëri, apo ndonjë përpjekje tjetër për deradikalizim të tyre.

Kërcënimet nga luftëtarët e huaj të kthyer ndaj shoqërisë sonë variojnë, duke pas parasysh se një shumicë e tyre ende mund të vazhdojnë ti mbahen ideologjive të tyre radikale. Ekziston mundësia që ish-luftëtarët e traumatizuar, të pa mjekuar të jenë më të prirur ndaj akteve të dhunës³, të njëjtit të vazhdojnë në përhapjen e ideologjive ekstreme

1 Deklaratë e Presidentit të R. së Maqedonisë, "Ivanovi - nga Siria janë kthyer 69 luftëtarë" [Иванов - Од Сирија се вратиле 69 борци во Македонија] <http://bit.ly/1V2kdjV>, 22.11.2015

2 Deklaratë e përbashkët e lëshuar nga partnerët në takimin ministror të Koalicionit kundër ISIL-it si dhe lista e shteteve pjesëmarrëse në koalicion: <http://1.usa.gov/1HZPBdG>

3 Foreign Policy: Çfarë të bëjmë kur luftëtarët e huaj të kthehen në shtëpi, <http://atfp.co/1G13MPD> 01.06.2015

dhe të ndihmojnë në rekrutimin e mëtejshëm të luftëtarëve të huaj.

Megjithatë, nga ana tjetër nuk duhet përjashtuar se disa nga ata luftëtarë të huaj ju kishin bashkangjitur këtyre fronteve heret si shkak i solidaritetit që ndjenin me popullin sirian për të luftuar regjimin shtypës të presidentit Assad. Disa prej tyre ju ishin bashkangjitur formacioneve paraushtarake para ISIS-it të krijohej zyrtarisht dhe arsyeja e kthimit të tyre në Maqedoni mund të lidhet pikërisht me zhgënjimet që ata mund të kenë me brutalitetin dhe në mënyrën se si ISIS-i po lufton. Këta luftëtarë të huaj të cilët janë kthyer në Maqedoni, për arsye pendimi duhen identifikuar dhe të njëjtit të shihen si aset i rendesishëm që do të mund të kontribuonin si për shtetin poashtu dhe për bashkësitë fetare në programet de-radikalizuese dhe reintegruese poqëse do të ekzistonin.

Në shtator të vitit 2014, Parlamenti i Maqedonisë miratoi ndryshimet në Kodin Penal ku pjesëmarrja nëpër ushtri të huaja, polici apo formacione paraushtarake do të dënohet me së paku 4 vite burg, ndërsa dënimi për organizimin dhe financimin e këtyre aktiviteteve do të jetë me më së paku 5 vite heqje lirie.⁴

Pasi u bënë ndryshimet ligjore, deri më tani ka pasur disa akcione policore të kryera si pjesë e një operacioni më të madh policor të quajtur „Kjelija (Qeliza)”, ku numri total i të arrestuarve nën dyshimin për pjesëmarrje në luftëra të huaja në Siri dhe Irak apo për rekrutim të luftëtarë të huaj në Maqedoni arriti në 12, ndërsa 23 të tjerë mbeten në arrati nën

4 Burg për pjesëmarrësit nëpër lufta të huaja [Затвор За Учество Во Странски Војски]: <http://www.akademik.mk/balkanot-4/>; 05.09.2014

dyshimin se ata mund gjenden aktualisht në Siri apo Irak.

Forcat e sigurisë kanë qenë vigjilentë duke mbajtur syte hapur rreth këtij kërcënimi. Pas sulmeve të Parisit, Maqedonia ngriti nivelin e saj të sigurisë nëpër objektet vitale në qytetin e Shkupit. Megjithatë, Maqedonia ende gjendet në një fazë të hershme të zhvillimit të strategjisë për luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm fetar⁵ dhe të parandalimit të radikalizimit të qytetarëve të saj.

Në Evropë, vendet si Gjermania, Franca, Belgjika apo Mbretëria e Bashkuar ofrojnë programe për de-radikalizim dhe reintegrim të ish-luftëtarëve të huaj. Shumica e këtyre programeve përqendrohen në tri fusha; ideologjike: në de-legjitimim dhe zhvlersim të narracioneve xhihadiste; pragmatike: duke asistuar ish-luftëtarët e huaj në punësim, arsimim apo trajnim, si dhe duke ju ofruar ndihma të ndryshme për strehim; fusha emocionale: ndihmë në adresimin e nevojave emocionale të ish-luftëtarëve të huaj duke shfrytëzuar edhe mbështetjen nga familjet e tyre si dhe krijimin e grupeve alternative referuese për ndihmë psikologjike.⁶

Në Maqedoni ide të ngjashme për programe të tilla u shfaqën si projekt-ide në fillim të 2015ës. Bashkësia Fetare Islame (BFI) ofroi një projekt propozim të quajtur STOP Rad-Terr ku ideja kryesore është parandalimi i radikalizimit, dhe për herë të parë u theksuan problemet që mund të lindin pas kthimit të shte-

5 Intervistë me Toni Jakimovskin, kordinator shtetëror për luftë kundër terrorizmit: <http://www.mia.mk/Mobile/mk/Home/RenderSingleNews/279?newsID=132888115>, 13.11.2015

6 Ish-luftëtarët e Huaj: Kriminalizim apo Reintegrim?: <http://brook.gs/1L8rSvw>, fq. 10, 2015

tasve të Maqedonisë që kanë marrë pjesë në luftërat e Sirisë apo Irakut. Qëllimi i këtij programi është krijimi i një sistemi të hershëm i cili do të jetë i gatshëm për tu ballafaquar me ish-luftëtarë të huaj kur fluksi i kthimit të tyre do të fillojë, të ndërtojë një sistem që do të ketë kapacitet të ofrojë mbështetje psikologjike ish-luftëtarëve të huaj si dhe anëtarëve të familjeve të tyre, sidomos në atë fushë se si të përballen me stigmatizimin shoqëror që ata do të ballafaqohen pas kthimit përsëri në shtëpi. Një aspekt tjetër i programit është përmes mësimëve islame nga imam kompetent të mos lejohen mendimet radikale të nxëne vend tek besimtarët.⁷

Sidoqofte ky projekt ende është në kërkim të mbështetjes institucionale dhe miratim të saj. Edhe pas një viti prej që kur u prezantua, asgjë nuk ka lëvizur në këtë drejtim. Kur ideja për reintegrim dhe resocializim u promovua fillimisht nga Bashkësia Fetare Islame (BFI), në fillim të vitit 2015ës ata u përballën me akuza të ashpra nëpër medime se si BFI-ja ka qasje të butë ndaj „terroristëve” dhe se kjo qasje mund të ketë efekt të kundërt, si promovim të mëtutjeshëm të radikalizimit.⁸

7 Kreu i BFI-së takoi Ambasadorin e SHBA-ve: <http://koha.mk/aktuale/35162-kreu-i-bfi-takohet-me-ambasadorin-bejli.html>, 05.03.2015

8 Xhihadistët nuk mund të lejohen në hargjim të shtetit tonë: <http://>

Mirëpo retorika që atëherë ka filluar të ndryshojë, ideja e të pasurit një program për parandalim dhe de-radikalizim paralelisht me masat supresive veçse të miratuara ka filluar të gjejë mirëkuptim në mesin e opinionit publik dhe institucioneve shtetërore, me çka mund ta vërejmë edhe në fjalimin përmbyllës të Presidentit të R. së Maqedonisë, ku ai bëri thirrje deri tek të gjitha institucionet ti ofrojnë ndihmë dhe mbështetje Bashkësisë Fetare Islame në luftën e saj kundër radikalizimit.⁹ Rëndësisë së udhëheqësve fetar dhe rolit të tyre të drejtpërdrejtë në këtë proces duhet vënë theks të posaçëm. Ato mund të kenë një rol padyshim shumë konstruktiv duke shpjeguar gabimet e ideologjisë së ISIS-it përmes kundër-argumentimeve dhe ligjeratave fetare.

Sa kanë pas sukses këto lloje të programeve për de-radikalizim të luftëtarëve të huaj ende është diskutabile, pasi ende nuk ka të dhëna që kundërshtojnë apo provojnë rezultate pozitive duke pas parasysh se i tërë ky proces është ende shumë në fillim dhe ende duke u zbatuar. Megjithatë ekzistojnë disa shembuj të mirë të cilat mund të konsiderohen të suk-

bit.ly/1Onsxvp, 28.01.2015

9 Siguria Shtetërore në fokus të fjalimit të Presidentit Ivanov: <http://bit.ly/1ZxaGUG>, 22.12.2015

sesshëm, të tillë si projekti „Hayat” në Gjermani i cila deri tani ka punuar në përafërsisht 130 raste, kryesisht meshkujt të cilët më së shpeshti raportohen nga anëtar të familjes, kur ata dyshojnë se anëtari i tyre i familjes është duke u radikalizuar, ky program poash-tu u ofron ish-luftëtarëve të huaj të burgosur mundësi për të ulur dënimet e tyre me burg duke bashkëpunuar me institucionet e sigurisë dhe duke u angazhuar në mënyrë aktive në programet ekzistuese për de-radikalizim.¹⁰

Nevoja për minimizim të kërcënimeve që vijnë nga ish-luftëtarët e huaj në Maqedoni është e pashmangshme, programe për parandalim nga radikalizimi i mëtejshëm i të tjerëve dhe programe që njëkohësisht do të përgatisnin këta njerëz për reintegrim, pasi ata të kenë shërbyer dënimet e tyre në burg duhen të merren parasysh. Kostoja nëse ilëmë këto çështje të pa-trajtuara është shumë më e lartë për shtetin. Shumë shpesh individët e re-socjalizuar kanë luajtur rol të rëndësishëm në fushatat kundër ideologjive radikale, pasi që ata cdoherë kanë mundësinë të flasin nga përvojat e tyre personale dhe nga pozita ku mund ti shpjegojë më mirë kurthet në të cilat kanë rënë vetë më herët. □

10 Ish-luftëtarët e Huaj: Kriminalizim apo Reintergim?: <http://brook.gs/1L8rSvw>, pg . 10, 2015



□ Shkruar nga, Kaltrina Selimi / kselimi@analyticamk.org
hulumtuëse në programin për Çështje të Jashtme dhe të Sigurisë
Analytica Thinking Laboratory
www.analyticamk.org / info@analyticamk.org